



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____._____.2022

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 414, DATË 8.7.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE DHE KRITEREVE TË NDARJES DHE TË PËRDORIMIT TË FONDIT TË KUSHTËZUAR TË BUXHETIT TË SHETIT PËR MBROJTJEN CIVILE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 65, të ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shkronja "ë", e pikës 3.1, të vendimit nr. 414, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", ndryshon, si më poshtë vijon:
"ë) për blerjen e automjeteve për përdorim të veçantë, makinave teknologjike dhe mjeteve rrugore të veçanta, të cilat përdoren për përbalimin e situatave emergjente të krijuara si pasojë e një fatkeqësie, si edhe për shpenzime të kryera për blerje karburanti dhe pjesësh ndërrimi për automjete dhe makineri të cilat përdoren për përbalimin e situatave emergjente të krijuara si pasojë e një fatkeqësie."
2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, bashkitë dhe prefektët e qarqeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama